



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 05-16-39427/16
Kaçanik, 21.12.2016

Në pajtim me Nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3, të Rregullës Financiare Nr.01/2013-MF – Shpenzimi i parave publike dhe Neni 12.2(a) dhe 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës së në mbledhjen e mbajtur me 21.12.2016, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RREGULLORES Nr. 06/2016

-PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Rregullorja Nr. 06/2016- Për kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura si në rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.
3. Rregullorja është hartuar nga DEFZH, përmban 13 faqe me gjithsej 27 nene, me numër të Protokollit 01Nr. 05-16-39427/16, dhe e njëjta është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Rregullores do të kujdeset, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja paraprake 01Nr. 16-27192/2012 e datës 31.10.2012- Për Përcaktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve dhe Ndryshim Plotësimet e saj, deri me miratimin e kësaj rregulloreje.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi